

KONKURS

Instituti **ATOMI**, me përkrahje nga **Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)** dhe me autorizimin e **Asociacionit Kangourou Sans Frontières (AKSF)**, organizon Garën Ndërkombëtare të Matematikës **Kangaroo – 2025 (Math Kangaroo Contest – Kosovo - MKC-K)** në Kosovë. Kangaroo është konkursi më i popullarizuar në botë për matematikë, që ka për qëllim promovimin dhe popullarizimin e matematikës, si dhe përkrahjen e talenteve të fushës së matematikës. Çdo vit, në tërë botën kanë marrë pjesë mbi **6 milionë nxënës nga mbi 80 shtete** të ndryshme të botës. **Me 22 mars 2025** të gjithë nxënësit e shkollave publike dhe private të Republikës së Kosovës mund të marrin pjesë në këtë konkurs. Në fund të gjithë nxënësit pjesëmarrës do të pajisen me Certifikata të pranuar ndërkombëtarisht, që pasqyrojnë rezultatin e tyre në këtë test.

KUSH MUND TË APLIKOJË?

Të gjithë nxënësit e Republikës së Kosovës **prej klasës II deri XII**, pa marrë parasysh suksesin e tyre nga matematika.

PËRFITIMET E MUNDSHME PËR MË TË SUKSESSHMIT:

- Shpërblime të ndryshme;
- Kurse dhe trajnime të avancuara (falas) nga profesionistët e matematikës;
- Mentorim nga profesionistët e matematikës;
- Qasje në literaturë të avancuar të matematikës;
- Mundësi pjesëmarrjeje në gara ndërkombëtare;
- Certifikim i njohur ndërkombëtarisht;
- Bursa shkollimi në shkollat cilësore të Kosovës.

PËR TË APLIKUAR:

Në faqen e internetit të MKC-K (www.kangaroo-ks.org) mund të merrni informatat shtesë për aplikim, përfshirë kontaktin e koordinatorëve rajonalë. Afati i aplikimit zgjatë **deri më 9 mars 2025**. Testimi do të mbahet të shtunën, më **22 mars 2025**. Aplikantët do të informohen me kohë përmes faqes së internetit dhe faqes së fejsbukut të MKC-K-së për kohën dhe vendin e mbajtjes së testimit.